




| | |
|---|-------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. | Nr. Prot. |
| Dep. <u>2-D / DPK</u> | Br. Prot. <u>01-1384/2012</u> |
| Nr. I faq. | Prot. No. |
| Broj stranica | Data |
| Nr. pages <u>02</u> | Datum <u>17-04-2012</u> |
| PRISHTINË | |



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **30.03.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4797/11, për z. *Lutfi ZHARKU* – Deputet në Kuvendin e Kosovës, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Lidhur me rastin nr. AKK-03-4784/11 të hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrtarin e lartë, *Lutfi Zharku* – Deputet në Kuvendin e Kosovës, janë ndërmmarrë veprimet e nevojshme sipas procedurës së paraparë ligjore për këtë situatë (Ligji Nr.04/L-051, Neni 18, pika 1).

Rasti është identifikuar me dyshimin e bazuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, që shfaqej nga ushtrimi i dy funksioneve të papajtueshme.

Një, si Deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në njëren anë, dhe

dy; ushtrimi i funksionit të Drejtorit menaxhues në biznesin privat “Kosovo Cement & Concrete Company” L.L.C., në anën tjetër.

Për këtë Zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese nga Agjencia Kundër Korrupsionit – AKK, me datën 29.02.2012 (Neni 18, paragrafi 5, Ligjit Nr.04/L-051).

Kësaj shkrese Zyrtari i Lartë – *Zharku*, i është përgjigjur me datën 15.03.2012 përmes një shkrese zyrtare, me të cilën, ai njofton Agjencinë kundër korrupsionit për ndryshime e bëra në biznesin e përmendur. Po ashtu, zyrtari *Zharku*, bashkangjitur ka dërguar edhe informacionet

mbi biznesin të lëshuara nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, të datës 14.03.2012, e në të cilat shihet se ztr. Lutfi Zharku nuk ushtron më pozitën, as Drejtorit Menaxhues, e as të Agjentit të Regjistruar të kësaj kompanie.

Kështu, me këto informacione zyrtare mbi biznesin, të lëshuara nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, që kanë ardhë në Agjencinë kundër Korrupsionit dhe kanë numër protokoli DPK/DPKI 03-1070/2012 , kemi konstatuar se është shmangur situata konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) .

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

